



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË

KOMUNA E ISTOGUT-Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson menaxherja, Zizë Bujupaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

"TRIO TEK" Shpk - nga Prishtina, të cilën e përfaqëson z. Halil Zabeli ne cilësinë e drejtorit të ndërmarrjës me nr. te Rexh. Biznesit 70819252(ne vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

"BLERJA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE PËR INSTITUCIONE KOMUNALE NE ISTOG

Nr. i prokurimit	633-18-7309-1-2-1 / B 05
Nr. i brëndshëm	633 / 018/ 014-R / 121

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë

"BLERJA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE PËR INSTITUCIONE KOMUNALE NE ISTOG

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 15. DITË pas porosisë se Autoritetit Kontraktues. nga dita e nënshkrimit të kontratës dhe të lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jenë Komuna Istog – DREJTORATI PER AMINISTRATË KOMUNALE – Ose vendi ku do ta caktojnë palët me marëveshje.

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetët DDP

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet total ne baze të kësajë kontrate është: **25.177,50 €**

Njezetepesëmi jëenjëçindeshtatëdhjetëeshtatëeuro50/100

4.2. Oferta financiare e furnitorit e datës: **19.10.2018** është pjesë përberese e kësajë kontrate dhe bazë për pagesën e furnitorit.

4.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Kjo marrëveshje e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare;

Plani për menaxhimin e kontratës

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet



6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës

së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kurdo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues: Komuna e Istogut		Për Kontraktorin: "Tio Tek"	
Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Halil Zabeli
Pozita:	Zyrtar Përgjegjes i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	29.10.2015 
Vula:		Vula:	